

Data 10.07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Ndërtim lerë uji në Ekonominë Pyjore Pezë, Krrabë-Gurrë, Shesh”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punë ndërtimore 45

Punë ndërtimi 45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

Fondi limit i procedurës është: 4,984,668 (katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **“Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit”** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”*

- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; përkatësisht në vlerën: **99,693.36 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre pikë tridhjetë e gjashtë) lekë** të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhë...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar/akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standartet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Çertifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 14001-2015 ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 45001-2015 ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe në VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (i ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/b dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, njësisia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe Kreut II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në prill të vitit 2026 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2026 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2025 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2023, 2024 dhe 2025.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (2026) sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me vlerë jo më të vogël se 10% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Për kontratat e realizuara si *bashkim operatorësh*, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë dhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
 - Për kontratat e realizuara si *Nënkontraktor*, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të

kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor stafin si më poshtë:

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 14 (katërmëdhjetë) punëtorë të thjeshtë që do të jenë përgjegjës për ndërhyrjen. Ky numër punonjësish është i nevojshëm për realizimin në kohë të punimeve të parashikuara në preventiv.

Numri total i ditëve të punës të llogaritura në preventivin e punimeve sipas normave të punimeve në pyje (Vendimi nr.839, datë 13.12.2025), në raport me numrin e ditëve të punës që një punëtor duhet të realizojë gjatë 1 muaji (22 ditë pune) rezulton të jetë prej 56 punëtorësh. Ky numër punëtorësh i shpërndarë sipas grafikut të parashikuar për realizimin e punimeve prej 4 muajsh, del një numër mesatar punëtorësh mujor prej 14 personash.

b) 1 (një) Drejtues Teknik për realizimin e kontratës, i cili duhet të jetë inxhinier pyjesh, e vërtetuar kjo me kontratë pune (të vlefshme), diplomë, librezë pune, CV dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë.

- Drejtuesi teknik duhet të jetë i pajisur me certifikatën (të vlefshme) e lëshuar nga Ministria përkatëse si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave.

Kjo certifikatë garanton eksperiencën dhe profesionalizmin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Për faktin që ekzekutimi i punimeve zbatohet specifikisht në fondin pyjor e kullosor dhe kriteret teknike të ekzekutimit të punimeve në krijimin e baseneve ujepirëse për blegtorinë, përfshirë elementë specifik (zbatimi i skicës, pjerrësia e skarpave, vendosja dhe lidhja e fletëve të plastmasit, aplikimi i shtresave të dheut mbi plastmas, formimi i shtresës së kalldrëmit etj.) kërkojnë ekspertizë të fushës së pyjeve dhe kullotave.

- Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një dekarate nga Administratori i shoqërisë se ky Drejtues Teknik duhet të jetë i punësuar pranë operatorit ekonomik me kohë të plotë pune dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera me qëllim që të ndjekë procesin. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik. Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.2, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar).*

c) 1 (një) shofer. Për këtë punonjës duhet të paraqitet leje drejtimi (e vlefshme), dëshmi e aftësisë profesionale/patente manovrimi e lëshuar nga “Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor” (e vlefshme), librezë pune, kontratë pune (e vlefshme).

d) 1 (një) punonjës i cili të disponojë certifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, (i ndryshuar).

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën muajin e fundit ose me anë të listëpagesave të punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën muajin e fundit, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Këto kriteret janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për ndihmën e parë dhe ndërhyrjet ndaj emergjencave dhe ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve.

Në mbështetje të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier” Autoriteti kontraktor duke vlerësuar të gjitha detyrat që mbulojnë këta punonjes për sigurinë në kantier ka gjykuar të jenë pjesë e stafit një punonjës i certifikuar pasi duhet të kryejë funksione të tilla të rëndësishme në kantier si mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodik të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve; caktojnë kufijtë dhe përgatitin zonën e stokeve dhe të depozitimit të materialeve, në veçanti kur bëhet fjalë për lëndë dhe substanca të rrezikshme; përshtatin në funksion të zhvillimit të kantierit, të kohëzgjatjes efektive që duhet t'i jepet llojeve të ndryshme të punës ose fazave të punës; kryejnë bashkëpunimin midis punëdhënësve dhe punëmarrësve të pavarur; kryejnë bashkëveprimin me aktivitetet që ndodhin në vendndodhje, brenda dhe në afërsi të kantierit.

Operatori ekonomik duke angazhuar punonjës të kualifikuar dhe me eksperience, vlerëson rëndësinë e projektit në fjalë rrit performancën e realizimit të projektit, rrit vlerën e investimit njerëzor në projekt dhe në këtë mënyrë siguron suksesin e përbashkët.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamionçinë me kapacitet mbajtës nën 1 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira

Kamionçina parashikohet si mjet i domosdoshëm logjistik për realizimin e projektit, me funksion transportin e materialeve, pajisjeve dhe stafit teknik në terren, duke garantuar zhvillimin efikas dhe në kohë të aktiviteteve të planifikuara.

- 1) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik;
- 2) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- 3) Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)
- c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- 4) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme);

- Operatori ekonomik ofertues duhet të vertetojë se disponon edhe vegla të ndryshme pune dhe pajisje të mbrojtjes personale në punë, si më poshtë:

Nr	Baza materiale	Njësia	Sasia
1	Kazmë	copë	min.15
2	Lopatë	copë	min.15
3	Çekiç	copë	min.3
4	Varre për thyerje gurësh	copë	min.3
5	Tokmak për ngjeshje dheu	copë	min.3
6	Karro dore	copë	min.6
7	Tezgë	copë	min.3
8	Doreza pune	palë	min.20

- 1) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes;
- 2) **Për mjetet dhe pajisjet teknike** që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë *foto* të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij;
- 3) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, nëpërmjet së cilës:
 - deklaron se mjetet dhe pajisjet e paraqitura sipas pikës 2.3.3 janë në dispozicion për realizimin e kontratës dhe nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese nga Autoriteti Kontraktor;
 - pranon të lejojë verifikimin e tyre nga Autoriteti Kontraktor në çdo kohë gjatë procedurës së prokurimit dhe deri në përfundimin e kontratës;
 - deklaron vendndodhjen e mjeteve dhe pajisjeve të paraqitura për qëllime verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa për veglat e punës të listuara në tabelën e mësipërme do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për veglat e punës, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenin 41 pika 6 ku citohet: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për kryerjen e shërbimit për permbushje me suksese të kontratës objekt prokurimi.

Në zbatim të pikës 1, dhe të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prova paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Këto të fundit për objektin e prokurimit „**Ndërtim lerë uji në Ekonominë Pyjore Pezë, Krrabë-Gurrë, Shesh**”, përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që e vlerëson këtë shërbim si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

Specifikimet teknike

Piketimi i lerës:

Lera do të ketë formë rrethore. Piketimi kryhet nga drejtuesi teknik i punimeve sipas përmasave të përcaktuara të lerës në projekt. Diametri i madh do të jetë 14.4 m (14.4+0.3 në gjërmim), diametri i vogël të jetë 6.2 m (6.2+0.3 në gjërmim), ndërsa thellësia e lerës 2.05m (2.05+0.4 në gjërmim). Përmasat e Lerës ujit pas ndërtimit të strukturave në perfundim duhet të rezultojnë: Diametri i madh 14.4 m, pa përfshirë trotuarin rreth e përqark lerës, diametri i vogël 6.2 m dhe thellësia e lerës 2.05 m. Mbi këtë bazë janë bërë dhe llogaritjet e volumeve të kapacitetit ujëmbledhës të lerës.

Gërmimet për hapjen e gropës

Fillojnë pasi janë bërë pikekimet e nevojshme sipas skicë-projektit të hartuar.

Në fillim gërmohet në perimetrin e vogël të tabanit të lerës dhe më pas vazhdohet paralelisht me formimin e skarpatës.

Përmasat në gjërmim: për thellësinë do të jetë 2.45m, për bazën e vogël (tabanin) në gjërmim do të jetë 6.5 m ndërsa dimensionin në gjërmim për bazën e madhe do të jetë 14.7 m duke respektuar projektin e hartuar.

Dheu largohet me karro dore në një largësi 10-20 ml. nga periferia e lerës. Dheu i shtresave pasardhëse gjithashtu transportohet me karro dore larg lerës, por një pjesë e tij që ka përmbajtje argjilore më të lartë dhe është i pastër nga prania e gurëve dhe mbeturinave, grumbullohet togje togje rreth periferisë së lerës për tu përdorur më vonë për bërjen e shtresave.

Me mbarimin e gërmimeve fillojmë me procesin e rrafshimit të skarpatave, uniformizimit dhe pastrimit nga çdo trup i huaj.

Shtrimi i fletëve të plasmasit.

Shtrimi i fletëve të plasmasit bëhet duke filluar nga aksi diametrik i lerës.

Shtresa e plasmasit është parashikuar më dysh. Për formimin e tegeleve të palosjeve buzët e fletëve të plasmasit mbivendosen në një hapsire 40 cm. Tegelet e palosjeve do të kenë një gjerësi maksimale 8 cm, çka do të thotë se parashikohen 5 palosje për formimin e tegelit.

Pas përfundimit të palosjeve të çdo tegeli mbi të vendosen gurë pllakatorë e me sipërfaqe të lëmuar për ti mbajtur ato në gjëndje të qëndrueshme. Me përfundimin e këtij procesi bëhet një kontroll i vëmendshëm përfundimtar për të parë ndonjë shmangie ose çrregullim të rastësishëm. Ky proces pune bëhet me këmbë zbatuar nga specialistët dhe punëtorët e kualifikuar për të mos rrezikuar çarjen e fletëve të plasmasit. Plasmasi duhet të jetë ndër më cilësorët në treg dhe me trashësi 0.25-0.3 mm.

Aplikimi i shtresës së dheut mbi plasmas.

Dheu që do të përdoret për shtresën nën dhe mbi plasmas (5 dhe 15 cm) fillimisht duhet të sitet duke e pastruar nga guralecët e pranishëm në të apo mbeturinat e tjera.

Formimi i shtresës së dheut nën plasmas (05 cm. trashësi) bëhet duke hedhur edhe mbushur gjithë hapsirën e gropës së hapur të lerës me dhe në trashësi 5 cm. Transporti i tij bëhet me tezgë dhe me karro dore nga 2 punëtor e më pas bëhet ngjeshja e dheut me tokmak të thjeshtë.

Formimi i shtresës së dheut mbi plasmas (15 cm. trashësi) bëhet duke filluar nga tabani i lerës.

Transporti i tij bëhet me tezgë nga 2 punëtor (zbatuar). Ngjeshja e dheut bëhet me tokmak të thjeshtë në prani të një lagështie të favorshme ngjeshjeje.

Gjatë formimit të shtresës së dheut hap pas hapi hiqen edhe gurët që janë vendosur përgjatë tegeleve të palosjeve dhe nxirren jashtë me tezgë.

Në periferinë e trotuarit të lerës bëhet një kanal me seksion tërthor 20 X 20 cm. ku futen mbarimet e fletëve të plasmasit dhe përgjatë tij mbi fletë vihen gurë me qëllim që ti fiksojnë ato. Shtresa e dheut pas përfundimit të ngjeshjes duhet të jetë në trashësinë 15 cm.

Shtresa e kalldrëmit.

Në lerat me plasmas, tufat pinë ujë brenda saj dhe një nga arsyet e shtresës së kalldrëmit me gurë kave është dhe lëvizja pa rrezik rreshqitjeje e tufave.

Shtresa e kalldrëmit aplikohet në të gjithë sipërfaqen e lerës. Gurët që do të përdoren për kalldrëm do të jenë gurë kave dhe do të vendosen në brinjë.

Në asnjë rast nuk duhet përdorur gurë lumi pasi tufat e bagëtive do ekspozoheshin ndaj rrezikut të rrëshqitjes me pasojë dëmtimin e mundshëm të tyre.

Trashësia e kalldrëmit është parashikuar 20 cm. Kalldrëmi duhet të jetë kompakt, gurët nuk duhet të lëvizin kur mbi ta ushtrohet pesha trupore dhe boshllëqet midis gurëve do të mbushen me gurë të vegjël të rrahur me çekan.

Muri rrethues.

Lerat kanë nevojë që të mbrohen nga depozitimi i prurjeve të ngurta në brendësi të tyre.

Në këto kushte duhet ndërtuar muri rrethues i cili ka funksion mbrojtës kundër prurjeve aluvionale. Si i tillë ai projektohet me pragje (4 pragje për hyrjen dhe daljen e tufave të bagëtive), por në varësi të terrenit ku do të ndërtohet lera numri i pragjeve mund të jetë më i vogël, kjo në funksion të vendosjes së murit rrethues për një mbrojtje sa më efektive të lerës nga prurjet e ngurta.

Muri rrethues do të ndërtohet përgjatë perimetrit të lerës (në distancë 20.7 m diametër).


Në vartësi të hapsirës së terrenit ku do ndërtohet lera, muri rrethues mund të ndërtohet në një distancë më të vogël se 20.7 m diametër përgjatë perimetrit të lerës por jo më të vogël se 15.7 m diametër.

Muri rrethues do ketë lartësi 50 cm mbi tokë (+30 cm themele) dhe gjerësi 50 cm.

Muri do të bëhet i thatë dhe mbi kurorën e tij aplikohet një shtresë betoni (C12/15) me trashësi 8 cm.

Profili i lerës

Prerja A – A dhe Prerja B – B



SHPJEGUES

D - Diametri i madh i lerës pas ndërt.të strukturave (14.4 m)
 D1-Diametri i madh i lerës (gërmim), (14.7 m)
 D2-Diametri i trotuarit (15.7 m)
 D3-Diametri i oborrit të lerës (20.7 m)
 d - Diametri i vogël i lerës pas ndërt.të strukturave (6.2 m)
 d1 - Diametri i vogël (gërmim), (6.5 m)
 h - Thellësia e lerës pas ndërt.të strukturave (2.05 m).
 h1 -Thellësia e lerës (gërmim), . (2.45 m)
 Vu-Kapaciteti ujembajtes i leres (180 m³)

Vg- Volumi gërmimeve (258 m³)
 Sk- Pjerrësia e skarpat.jo më e vogël se 2:1 ($\leq 50\%$)
 H - Thellësia e konit të lerës (4.6 m)
 Sb - Sipërfaqja e bazës së vogël (33.2 m²)
 Sa - Sipërfaqja anësore e lerës (153 m²)
 St - Sipërfaqja e trotuarit (23.9 m²)
 So - Sipërfaqja e oborrit (246 m²)
 M.Rr- Muri rrethues i lerës (15.98 m³)

Grafiku i punimeve

Punimet për ndërtimin e lerës së ujit, do zbatohen sipas kontratës që do lidhet, dhe do të kryhen duke zgjedhur periudhën (ditët) pa reshje.

Aktiviteti	Muaji <i>(kutintë e selektuara tregojnë aktivitetet e planifikuara, nga muaji i parë i zbatimit të projektit)</i>				Grupi i implementimit
	1	2	3	4	
Sigurimi i bazës materiale					Administratori i shoqërisë dhe drejtuesi teknik.
Ngritja e ekipit të punës dhe trajnimi i punëtorëve					Drejtuesi teknik.
Njohja me terrenin (vendi ku do të zbatohet projekti)					Punëtorja, drejtuesi teknik, perf.komunitetit dhe grupi i monitorimit.
Zbatimi i punimeve Identifikimi, materializimi i vendit ku do të ndërtohet lera e ujit dhe piketimi sipas projektit					Drejtuesi teknik i punimeve
Gërmim dheu,transport me k.d dis.20ml,Rafshim skarpate me krahë					Punëtorja. Drejtuesi teknik
Shtrim plasmasi (2 shtresa), Shoshje dheu Transport dheu me tezgë, hedhje,ngjeshje dheu me tokmak 20 cm trashësi (5 dhe 15 cm)					Punëtorja. Drejtuesi teknik
Nxjerrje gure kave, transport i largët auto, transport gurësh me k.d dhe tezgë 20 ml					Punëtorja. Drejtuesi teknik
Shtrim kalldrëmi 20 cm i lartë					Punëtorja. Drejtuesi teknik
Pastrim oborri lere nga bimësia, skarifikim dhe mbjellje bari					
Ndërtim mur guri mbajtës e themele llac cemento dhe shtresë brez betoni					Punëtorja. Drejtuesi teknik
Kontrolli i punimeve					Grupi i monitorimit, Drejtuesi teknik.
Marrja në dorëzim					Grupi i monitorimit, Drejtuesi teknik.

Specifikimet teknike janë hartuar për punën objekt prokurimi, në përputhje me kërkesat dhe përshkrimin teknik të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, të cilat janë bashkëlidhur DST-së.

***Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim**